




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 43, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenin 3 paragrafi 1 pika 1.2 dhe neni 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 37 pika 1,3 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, i datës 03.12.2008, si dhe neni 5 Rregullores së Punë se Kuvendit, si dhe ne pajtim me rregullat e procedurës për mbajtjen e mbledhjeve, Kryesuesja e kuvendit, znj. Adelina Spahiu - Alija:

T H Ë R R E T

Mbledhjen e Rregullt të Kuvendit Komunal të Skenderaj, e cila do të mbahet me datë 29.09.2026, (ditë e Marte), me fillim prej orën 10:00, në Sallën e Kuvendit.

Mbledhja do të ketë këtë:

REND DITE

1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara;
4. Propozim – Vendim për miratimin e buxhetit të Komunës së Skenderajt për vitin 2027 dhe parashikimi i buxhetit për vitin 2028-2029, (**raporton z. Behxhet Maliqi, Drejtor i DBF**),
5. Propozim – Vendim mbi lejimin e shfrytëzimit të mjeteve financiare në shumë prej 10,000€ (dhjetë mijë euro), për mbështetje financiare për Osman Bytyqi nga Fshati Abri e Poshtme, për rindërtim të shtëpisë së djegur si pasojë e zjarrit, (**raporton Kryetari i Komunës, z. Sami Lushtaku**),
6. Propozim për miratimin e vendimit për mbështetjen financiare për NPL Eko- Natyra SH.A. Skenderaj me shumën prej 50,000.00€ (**raporton Kryetari i Komunës z. Sami Lushtaku**),
7. Propozim për miratimin paraprak të vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të Komunës së Skenderaj, në shfrytëzim afatgjatë deri në 99 vite personit fizik/ juridik, parcelat me numër 699-10, 565-2, 569-0, dhe 570-1 prona publike në pronësi të Komunës, zona Kadastrale Skenderaj(**raporton z. Granit Musliu, drejtor DGJKP**),
8. Propozim për miratimin e vendimit për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës, përmes procedurës së shprehjes së interesit; parcelat Kadastrale me numër 699-10, 565-2, 569-0, dhe 570-1 prona publike në pronësi të Komunës zona Kadastrale Skenderaj, (**raporton z. Granit Musliu, drejtor DGJKP**),
9. Propozim për miratimin e vendimit për formimin e Komisionit të ankesave për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës së Skenderajt, (**raporton z. Granit Musliu, drejtor DGJKP**),
10. Propozim – Vendim për miratimin e Draft – Planit Komunal për Ri-integrimin e qëndrueshëm të personave të Ri-atdhesuar dhe integrimi e të huajve në Komunën e Skenderajt 2026-2028,(**raporton Zyrtari për Komunitete dhe Kthim, z. Fatmir Balaj**),

11. Propozim – Vendim për shfuqizimin e vendimit Nr. 01-020/01-0020578/26, të datës; 04.06.2026, bazuar ne rekomandimin e Mapl-së, për zëvendësimin e anëtares se komitetit për komunitete (**raporton Kryesuesja e Kuvendit znj. Adelina Spahiu – Alija**),
12. Diskutim rreth raportit të performancës së Komunave për vitin 2025, (raporton koordinatori i performancës komunale, z. Baki Beqiri),
13. Pyetjet e këshilltare nën piken të ndryshme.

KRYSUESJA E KUVENDIT





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠTINE
SKENDERAJ
Nr. 01-052/01-0040246/26
Data 21.09.2026



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 49, të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040, të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 43 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, të datës 03.12.2008, si dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit nenit 27, e në pajtim me rregullat e procedurës.

Ekstrakt nga procesverbali i MBLEDHJES SË KUVENDIT KOMUNAL SKENDERAJ,
i datës; 31.07.2026, ora 10:00

REND DITE

1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara;
4. Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Skenderajt për vitin 2025, dhe plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditorit të jashtëm, (**raporton drejtori i DBF-së, z. Behxhet Maliqi**) ;
5. Raporti financiar gjashtëmujor janar – qershor 2026, (**raporton drejtori i DBF-së, z. Behxhet Maliqi**) ;
6. Raporti gjashtëmujor i Këshillit për siguri në bashkësi për periudhën janar – qershor 2026, (**raporton Kryetari i Komunës z. Sami Lushtaku**) ;
7. Propozim - Vendim për miratimin e raportit përfundimtar nr.02-052/01-0027129/26, i datës; 15.07.2026, i hartuar nga komisioni komunal për vlerësimin e dëmeve si pasojë e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera për periudhën Janar - Qershor 2026, dëme të shkaktuara në bujqësi, në territorin e Komunës së Skenderajt, në vlerë totale 141,926.39 Euro, (**raporton Kryetari i Komisionit z. Hajzer Shala**) ;
8. Propozim – Vendim për caktimin e lokacionit për objektin e Ndërmarrjes Eko – Natyra, (**raporton Kryetari i Komunës z. Sami Lushtaku**) ;
9. Propozim – Vendim për shfuqizimin e vendimit për lejimin e shfrytëzimit të mjeteve financiare në shumë prej 5,000€ për mbështetje financiare për konferencën ndërkombëtare nga platforma Liria ka Emër, (**raporton Kryetari i Komunës z. Sami Lushtaku**);
10. Pyetjet e këshilltare nën piken të ndryshme.

Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija : Përshëndetje i nderuar Kryetar i Komunës se Skenderajt z. Sami Lushtaku, i nderuari Nënkyetar z. Fadil Nura, te nderuar përfaqësues te Mapl, anëtar te Kuvendit, drejtor te drejtorive, dhe ju te gjithë te pranishmit, te pranishëm ne sallë i kemi 25 anëtar, mungon me arsye Kushtrim Dragaj, mungon pa arsye Hysni Mehani, vazhdojmë me miratimin e rendit te ditës, e hap debatin, pasi qe nuk ka tjerë për diskutim shkojmë me votim, konstatojmë se me 20 vota për, 2 kundër dhe 0 abstenim miratohet rendit i ditës, vazhdojmë me piken e radhës shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e hapi diskutimin pasi qe nuk ka për te diskutuar shkojmë ne votim, konstatojmë se me 21 për, 0 kundër dhe 2 abstenime miratohet procesverbali nga mbledhja e kaluar, vazhdojmë me piken 4 te radhës Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Skenderajt për vitin 2025, dhe plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditorit të jashtëm, (**raporton drejtori i DBF-së, z. Behxhet Maliqi**) ;

Behxhet Maliqi, DBF - Faleminderit Kryesuese, përshëndetje Nënkyetar, drejtor te drejtorive, anëtar te Kuvendit dhe ju te gjithë të pranishmit, para vetes e keni raportin e auditorit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Skenderajt dhe plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve te auditorit të jashtëm, po paraqes ne pika te shkurtera pasi qe e keni marr materialin me kohë është një raport i pasqyrave financiare me disa te gjetura qe nuk ka pasur mundësi Komuna me i evituar këto të gjetura te cilat kanë qenë të lidhura me nivelin qendror, gjithsej kanë qenë 11 të gjetura, pasi qe materialin e keni para jush po i prezantoj në pika të shkurtura ne faqen 3 i shihni B1 Shpenzime në vlerë prej 493,807€ janë paguar dhe regjistruar ne kategorinë jo adekuate, pastaj B2 detyrimet kontigjente te prezantuara ne pasqyrat vjetore financiare janë mbivlerësuar për 127,978, konsideroj se ky raport paraqet punën e jashtëzakonshme qe ka bërë Komuna e jonë, pastaj e shihni planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve te auditorit të jashtëm, prezanton 11 çështjet neper kolona, nuk po e zgjati me shume nëse keni pyetje urdhëroni.

Afrim Kabashi, NSD – Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë, raporti i auditorit ka rezultuar me 11 rekomandime, prej tyre janë 8 të përsëritura, a ka mundësi drejtor me na tregu se neper cilat drejtori janë këto të gjetura, cili është plani i veprimit qe këto 8 të gjetura mos me na u përsërit prapë, faleminderit.

Behxhet Maliqi, DBF - Faleminderit Afrim, realisht janë disa të gjetura të përsëritura, këtë vite do mundohemi te mos na u përsëritën më, disa te gjetura i vlerësoj ma shumë janë te natyrës teknike, dhe disa janë si shkake i neglizhencës se stafit e qe nuk do lejojmë me më ndodh, këto te gjetura kanë ndodh ne financa si dhe tek avokati Komunal si dhe ne disa drejtori.

Floriana Halili, LVV – Faleminderit Kryesuese përshëndetje për të gjithë sa i përket këtij raportit secili e dimë se nuk është real nuk është i drejtë këto te gjetura janë shqetësuese dhe po vërehet se ende po keni fuqinë me ndiku ne ndryshimin e këtij raporti, ju mundeni me ndryshuar raportin po keq qeverisjen e juaj e din qytetaret, shihen 12 të gjetura te një çështje mbi 5 milion euro nuk janë realizuar ne afat kohor auditori thotë se ky mos realizim ka ndiku si shkake i mos kontrollit te mjaftueshëm nga Komuna, pastaj mjete te paguara te përmbaruesi për mos pagës te rrymës për çerdhe, pastaj llogarit e arketushme nuk kanë qene te sakta ne përgjithësi ky raport pasqyron se Komuna e jone nuk është e afte me mbikëqyr buxhetin e saj.

Behxhet Maliqi, DBF - Me qe nuk je ekonomiste nuk po paragjykoj, e para politik me pasqyra financiare nuk është mire me ba, raporti i auditorit është i qartë është raport i kualifikuar është raport i drejtë i pasqyrave financiare dhe te bazuar ligjërisht dhe nuk është mire me kesi vlerësimesh për institucionet e pavarura, leni institucionet le ti kryejnë punët e veta.

Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija : Pasi qe nuk ka tjerë për diskutim, shkojmë në votim, konstatojmë se me 20 vota për, 0 kundër dhe 2 abstenime, përkrahet raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Skenderajt për vitin 2025, dhe plani i veprimtë për zbatimin e rekomandimeve të auditorit të jashtëm, vazhdojmë me piken e radhës Raporti financiar gjashtëmuor janar – qershor 2026, (**raporton drejtori i DBF-së, z. Behxhet Maliqi**) ;

Behxhet Maliqi, DBF – Faleminderit Kryesuesë, para vetes keni raportin financiar gjashtëmuor janar – qershor 2026, po e paraqes ne pika te shkurtera pasi qe materialin e keni marr me kohë, ky raport është përgatitur ne përputhje me kërkesat ligjore për raportim, bazuar ne ligjin për financat publike dhe përgjegjësit, paraqet realizimin e buxhetit për këtë periudhë raportuese , pastaj paraqet burimin e te hyrave sipas burimeve neper programe, ne faqen 4 i shihni shpenzimet sipas kategorive ekonomike buxheti fillestar 20,245,396.00€ ndërsa buxheti i shpenzuar 11,785,332.21€ pastaj i shihni ne tabelat ne vazhdim shpenzimet dhe te hyrat neper drejtori, prezanton tabelat ne raport.

Afrim Kabashi, NSD – Flm Kryesuse, Drejtor e kam lexuar raportin financiar 6 muor 2026,në raport keni theksuar se sumvencionet dhe transferet kanë shenuar realizim çrej 46.96% te fondit aktual,dhe i ke potencuar në cillat programe,porë pasiqe i perkas atij profesioni dua te di qka është sumvencionuar në bujqësi konkretisht në cillat programe nga komuna apo është bashkëpjesmarrse në sumvencionimin e ndonjë projekti te realizuar nga ndonjë organizat e komuna participon në projekt..Tek shpenzimet buxhetore në raport ke theksuar se ka rritje te shpenzimeve në krahasim me vitet paraprake,ndërsa te hyrat vetanake te arketuara kanë arritur vleren 647.880.98 Eurove qe perfaqesonë 37.22% te pkanifikimit vjetor krahasuar në te njëjen periudhë te vitit paraprak 2025 niveli i arkëtimit është mai i ulët prandaj në bazë te kësaj si do te mund te realizohen projektet e planifikuar per tu realizuar,apo do te mbesin projekte te premtuara si në vitet paraprake.Do ti veqojë disa kode tek llojet e shpenzimeve.Tek tabela nr 3 llojet e shpenzimeve sipasë kategorive.Tek kodi 13310-interneti vlara e shpenzimit 5472€Tek kodi 13445-sherbimet e veqanta konsulenc dhe kontraktor individual shpenzime te bëra 6277.70€Tek kodi 13610 furnizim per zyre vlara e shpenzuar 73414.03€.A ka mundësi drejtor te na informoni pse aqë shumë shpenzime te krijuara në këtë 6-mujor në krahasim me 6-mujorin e vitit 2025.Tek tabela nr 5 shpenzimet sipase programeve pyetja ime është pse departmenti i Buxhetit,Sherbimeve Publike,ZLK-së,Bujqësis,Zhvillimit

Ekonomik,Gjeodozisë,Urbanizmit,Kulturës,Shendësisë,Arsimit po i mungojnë kodet e shpenzimeve,kemi te bëjmë me gabim teknik apo qfarë bëhet fjalë.Tek tabela nr 5 shpenzimet sipase programeve tek drejtorja e administratës kodi nr 13140 Transporti per udhetime jashtë vendit shuma e shpenzuar 2694€,si dhe kodi nr 13142 Akomodim per udhëtime jashtë vendit shuma 1221€ këto shpenzime janë krijuar nga Drejtori dhe stafi i drejtorisë,apo janë bartur nga drejtorja e lartë cekur në ndonjë program tjetër.Tek kodi 13620 furnizim me ushqim dhe pije(jo dreka zyrtare)shpenzime te bëra 5598€ shpenzime te krijuara bajagi mirë.Tek kodi 14010 te mirmbajtaja dhe riparimi i utomjeteve shuma e shpenzuar 3907€ shpenzime te krijuara kogja mirë e kurë dihet se kemi vetura te blera tashë vonë.Kodi 14023 mirmbajtja e ndërtesav arsimore shuma 25770€ cillat janë arsyet mi pague drejtorja e administrates kurë dihet qdo njëra drejtori e ka buxhetin e vetë per shpenzim,apo kemi te bëjmë në bartje në huazim nga drejtorja në drejtori.Tek kodi 13460-Sherbimet kontraktuese tjera shpenzim i bër 29252€ ,dhe tek kodi 14032 mirmbajtja e rrugëve lokale shpenzim i krijuar 96430€ tek Drejtorja e Inspektionit,kërkojmë informata nga ti Drejtor apo nga Drejtoret e drejtorive perkatse.

Behxhet Maliqi, DBF – Faleminderit Afrim, për realizimin e te hyrave është e vërtetë se janë realizu me pak te hyra se periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, mirëpo shpresoj se do ta arrijmë deri

ne fund viti planin e relizimit te te hyrave, te shpenzimet për furnizim për zyre kane qene disa obligime te vitit te kaluar pa paguar dhe i kemi paguar, tek mirëmbajtja rutinore janë disa shërbime te Eko natyrës, pastaj tek mirëmbajtje e paisje tjera hyjnë kamerat e objekteve te Komunës.

Afrim Kabashi, NSD – Një pyetje për Nënkryetarin pasi qe është jurist a keni ndonjë kod buxhetor qe nuk guxon përmbaruesi me i marr mjetet jo me pas problem edhe fillimin e shkollës atje me i marr përmbaruesi mjetet.

Nënkryetari, z. Fadil Nura – Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë, Afrim pyetje me vend, kontrata kolektive është kontrate e lidhur me nivelin qendror qe ua kane lenë barrë Komunave, mirëpo mos me pas telashe te tilla për shpenzime esenciale duhet mu mundu me te hyra vetanake me i mbulu disa shpenzime bazike, Komunat e kane dërgua në Gjykatë çështjen e kontratën kolektive.

Rrezarta Hasani – Ibrahim, PDK – Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë, ne bazë të raportit shuma e te hyrave vetanake qe janë realizuar ne ketë 6 mujor janë 37.22% është përqindje e ulet cilat masa do ti ndërmerrni me e realizu planin e planifikun, pastaj realizimi i inkasimit tek tatimi ne pronë 32% ndërsa borxhet e qytetareve janë me te larta, çfarë masash do ti ndërmerrni, edhe një sqarim tek drejtoria e arsimit tek te hyrat nga participimi i fëmijëve për pagës te çerdhes 15 mijë Euro me pakë se vitin e kaluar cila është arsyeja e kësaj përqindje kaq të vogël, duke e ditë se numri i çerdheve është rritur, për drejtorin e shëndetësisë për pagesën e gjobës për cilën gjobë bëhet fjalë, faleminderit.

Behxhet Maliqi, DBF – Faleminderit Rrezarta pyetje shume me vend e vertete se kemi përqindje me te ulet te inkasimit tek te hyrat vetanake, kemi marr hapa u kemi dergu njoftime për pagës te borxheve si ne tatim ne prone ashtu edhe drejtorit tjera për borxhe qe kane ndaj Komunës, besoj se deri ne fund të vitit do ta arrijmë planin me realizuar, faleminderit.

Kastriot Duraku, DKA - Përshëndetje për të gjithë, ne çerdhet tona janë një numër qe lirohen nga pagesa e participimit te bazuar ne rregulloren Komunale, te tjerët paguajnë mirëpo ende financat nuk i kanë kaluar ne sistem pagesat qe janë bërë tek drejtoria e arsimit, faleminderit.

Hasan Hoti, DSHMS – Përshëndetje për të gjithë, rrethe gjobës bëhet fjale për një gjobë qe e kane shqiptuar në QKMF inspektoriat gjobë 2000€ bashke me Avokatin e Komunës kemi ndërmarr hapa ligjore rrethe saj.

Floriana Halili, LVV – Tek kodi 13430 shërbimet shëndetësore, për vitin 2026, shuma prej 75,000.00€ çka përfshin.

Behxhet Maliqi, DBF – Ky kod përfshin shërbimet qe i ofron Kosova Med, shërbimet shëndetësore qe i jep.

Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija : Pasi qe nuk ka tjerë për diskutim, shkojmë ne votim, konstatojmë se me 20 për, 0 kundër dhe 2 abstenim, përkrahet Raporti financiar gjashtëmujor janar – qershor 2026, vazhdojmë me piken e 6 Raporti gjashtëmujor i Këshillit për siguri në bashkësi për periudhën janar – qershor 2026, raporton Nënkryetari.

Nënkryetari, z. Fadil Nura - Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë raporti 6 mujor përfshin punën dhe aktivitetet qe janë kryer ne KKSBB, ky këshill është trup e Kuvendit ne te cilën janë trajtuar tema te ndryshme ne dobi te komunitetit, konkretisht çështje te sigurisë, gjate kësaj periudhe KKSBB ka mbajte 3 takime ne te cilat janë nxjerr rekomandime te ndryshme, nuk po e zgjati me shume te gjitha punët qe janë kryer i shihni ne raport, faleminderit.

Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija : E hapi diskutimin për këtë pikë, pasi qe nuk ka për diskutim, shkojmë në votim, konstatojmë se me 20 për, 2 kundër, dhe 0 abstenim, përkrahet raporti 6 mujor i KKSBB-së, vazhdojmë me piken e radhës Propozim - Vendim për miratimin e raportit përfundimtar nr.02-052/01-0027129/26, i datës; 15.07.2026, i hartuar nga komisioni

komunal për vlerësimin e dëmeve si pasojë e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera për periudhën Janar - Qershor 2026, dëme të shkaktuara në bujqësi, në territorin e Komunës së Skenderajt, në vlerë totale 141,926.39 Euro,(raporton **Kryetari i Komisionit z. Hajzer Shala**) ; **Hajzer Shala, Kryetar i Komisionit** – Faleminderit Kryesuesë, përshëndetje për të gjithë, gjatë periudhës janar – qershor 2026, kanë qene gjithsej 16 raste të dëmeve në bujqësi 15 nga ngricat dhe 1 nga zjarri, shuma totale e dëmit është 141,926.39€, komisioni i ka trajtu te gjitha ka nxjerr raport te vlerësimit te cilin e keni në material, nuk po e zgjas me shumë, faleminderit.

Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija : Faleminderit e hapi diskutimin.

Floriana Halili, LVV – Faleminderit Kryesuesë, nuk jam kundër përkrahjes se fermerëve, mirëpo në nuk po e dimë as kush janë këta, çka janë dëmtuar, nuk dimë se çka te votojmë, i keni fsheh emrat.

Hajzer Shala, Kryetar i Komisionit – Emrat janë mbyllë për shkakë te privatësisë, nuk ka arsye tjera, keni te drejtën e qasjes në te gjitha dokumentet, të gjithë janë fermerë të Komunës sonë, pa problem e keni te drejtën ligjore në te gjitha këto lista e dokumente.

Nënkryetari, z. Fadil Nura - Po e shoh te nevojshme me sqaru, nuk po i publikojnë emrat vetëm për shkakë te privatësisë, mirëpo keni te drejt në qasje te plot në dokument, kërkon i pa problem komisioni ju ofron te gjitha informatat.

Abdullah Gashi, PDK – Përshëndetje për të gjithë, kurgju te keqe nuk do kishte nëse do ishin emrat le te dihet kush janë përfituesit pse mos me qene ma transparent.

Nezir Bejta, LVV – Mbasi është Kryetari i Komunës këtu, le te na sqaroj pse me u fsheh emrat.

Hajzer Shala, Kryetar i Komisionit – 15 fermer janë nga ngricat dhe vetëm 1 nga zjarri.

Sabit Ferizi, DBPZHR – Keto janë nga ngricat e muajit majë, qe i ka dëmtuar shume pemishte.

Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija : Pasi qe nuk ka tjerë për diskutim, shkojmë në votim konstatojmë se me 20 për, 2 kundër, dhe 0 abstenim miratohet raporti përfundimtar për dëmet, janar – qershor 2026, vazhdojmë me piken e radhës Propozim – Vendim për caktimin e lokacionit për objektin e Ndërmarrjes Eko – Natyra, raporton Nënkryetari i Komunës,

Nënkryetari, z. Fadil Nura - Propozimi në fjale vije pas kërkesës së Ndërmarrjes Eko Natyra, për definimin e pronësisë, për shkakë se te cilët aplikojnë në projekte të ndryshme e kriter duhet te jete çështja e pronësisë, e qe ajo prone është në pronësi te Komunës, kërkoj qe këtij propozimi ti shtohet edhe një pjesë nenit 3 i jepet në shfrytëzim prona komunale me sipërfaqe dhe lokacion te përcaktuar me certifikatë dhe kopje te planit te cilat janë te bashkangjitur në propozim, andaj kërkoj qe ta miratoni këtë propozim – vendim, faleminderit.

Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija : Faleminderit, Nënkryetar, e hapi diskutimin.

Nezir Bejta, LVV – Në cilën pjesë të qytetit gjendet kjo parcelë.

Abdullah Gashi, LVV – Unë mendoj se është një propozim shume me vend, pasi qe kjo ndërmarrje po bene pune të shkëlqyer.

Afrim Kabashi, NSD – Nëse meriton dikush komplimente për punën qe bëjnë atëherë ata janë Eko – Natyra, po bëjnë punë të mrekullueshme.

Nënkryetari, z. Fadil Nura – Parcela është tek objekti ku është ndërtuar për ndërmarrjen.

Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija : Pasi qe tjerë për diskutim nuk ka, shkojmë në votim, konstatojmë se me 21 vota për, 0 kundër dhe 2 abstenime, miratohet Propozim – Vendim për caktimin e lokacionit për objektin e Ndërmarrjes Eko – Natyra, vazhdojmë me piken e radhës, Propozim – Vendim për shfuqizimin e vendimit për lejimin e shfrytëzimit të mjeteve financiare në shumë prej 5,000€ për mbështetje financiare për konferencën ndërkombëtare nga platforma Liria ka Emër, raporton Nënkryetari i Komunës,

Nënkryetari, z. Fadil Nura - Faleminderit Kryesuese, propozimi në fjale ka të bëjë me mbështetjen financiare për platformën Liria Ka Emër, të cilën e kemi mbështet me shumë prej 5000€ e që të cilin vendim Ministria e financave na e ka kthyer të jashtëligjshëm me arsyetimet jo mire të sqaruara e që në për shkak të grandit të performances e kemi sjell për shfuqizim edhe pse Komuna ka kompetenca me të zgjeruara financiare pasi që vete asambleja e miraton vete buxhetin e mundësit për mbështetje të tilla financiare i ka mirëpo si do qofte në të shfuqizojmë dhe kërkoj që ta miratoni këtë propozim- vendim, faleminderit.

Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija : Faleminderit Nënkryetar, e hapi diskutimin, pasi që nuk ka për diskutim, shkojmë në votim, konstatojmë se me 25 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet Propozim – Vendim për caktimin e lokacionit për objektin e Ndërmarrjes Eko – Natyra, vazhdojmë me piken e radhës, Propozim – Vendim për shfuqizimin e vendimit për lejimin e shfrytëzimit të mjeteve financiare në shumë prej 5,000€ për mbështetje financiare për konferencën ndërkombëtare nga platforma Liria ka Emër, vazhdojmë me piken e radhës pyetjet e këshilltareve nën piken të ndryshme.

Abdulla Gashi , PDK – Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë këto janë pyetjet e mia për këtë seancë Për Drejtorin e Shërbimeve publike z.Arber GeciPërshëndetje,Dëshiroj t'ju parashtroj një shqetësim lidhur me bllokimin e kanalizimit në zonën e rrugës Ilaz Kodra, pranë Viva Fresh dhe Stadiumit të Futbollit Bajram Aliu. Sa herë që ka reshje shiu, krijohen vërshime të ujit që po shkaktojnë dëme të konsiderueshme në bizneset e kësaj zone.A keni mundësi të ndërmerri masa konkrete për zgjidhjen e këtij problemi dhe për t'i mbrojtur bizneset nga dëmtimet e mëtejshme që shkaktohen nga uji?Pyetje për drejtorin për shëndetësisë dhe mirëqenie sociale z. Hasan Hoti: Drejtor, a mund të na tregoni se çfarë është bërë me lifin e QKMF-së? A është rregulluar dhe a është aktualisht funksional? Qytetarët do të vlerësonin një informim lidhur me këtë çështje.Faleminderit!

Arber Geci, DPSH – I nderuari Gashi, e kemi evidentuar atë problematik, dhe kemi interveni mirëpo nuk është zgjidh problemi, presim deri ta kontraktujmë ndonjë operator e do ta zgjidhim atë problematik.

Hasan Hoti, DSHMS - Faleminderit për pyetjen, sa i përket ashensorit në QKMF, tash me është në funksion.

Afrim Kabashi, NSD – Faleminderit Kryesuese, pyetjet e mira janë këto Per Drejtorin për shërbime publike,apo drejtorin e inspektionit.Drejtor nën perkujdesjen e kujtë është objekti i dedikuar për varrosjen e qytetarve të Skenderajit në lokacionin e ishë varrezave të deshmorve në Polac,dhe a është ndërmarrë diçka për perkujdesjen e këtij objekti kur kihet parasyshtë dëmtimet që janë bërë nga dora e njeriut.Fotot tregojnë demtimin e bërë në këtë objekt!2.)Per Drejtorin për UrbanizemDrejtor a ka mundësi buxhetore për rregullimin e rrethërotullimit në pjesën e rrugës Polac-Vushtrri gjegjesishtë në pjesën ku lidhen lagjet e Gjamis,Koci dhe Xani,ku do të bëhej zgjidhje pozitive për evitimin e ndeshjeve në komunikacion të cillat janë bërë evidente qdo javë!3.)Per Drejtorin për urbanizemDrejtor sa janë mundësit buxhetore për të intervenuar në rehabilitimin e rrugës Mikushnic-Gojfile ku thuajse është bërë e pakalushme për vetura! Per drejtorin e bujqesise A keni planifikuar në buxhetin e paraparë në perkrahje të bujqëve në raste të fatkeqsive natyrore,e pikerisht tashë sa janë mundësit që të perkrahen fermeret e demtuar nga Bresheri e kurë kemi parasyshtë dëmtimi ka ndodhë në frytdhënje!

Arber Geci, DPSH – I nderuari Kabashi, jemi ne dijeni për dëmtimet e pjesës te varrezat e qytetit, do te ndërmarrim masa, është pastru ajo pjese nga Eko – Natyra, edhe pjesën e objektit te varrezave si te krijohen mundësit financiare do ta rregullojmë.

Arbnor Citaku, DUMA - Afrim i dimë ato probleme me rrugë, vetë i kam vizituar mirëpo nuk kemi buxhet këto janë mundësit, kur te kem mundësi financiare do ti trajtojmë.


Sabit Ferizi, DBPZHR – Afrim asnjë Komunë nuk ka fond për përkrahje financiare te fermerëve ne rastet e fatkeqësive natyrore, ne si Komune i vlerësojmë me Komisionet tona i përcjellim ne nivel qendrore për kompensim.

Kryesuesja e Kuvendit, Adelina Spahiu – Alija : Pasi qe veç i trajtuam te gjitha pikat e rendit të ditës, e mbylli këtë takim, ju uroje pushime te mira, ne muajin Gusht nuk do mbajmë seance, kaloni mire, deri ne seancën e radhës.

Procesmbajtësi



Kryesuesja e Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Kuvendi i Komunës Skenderaj
Skupština Opštine Skenderaj
Skenderaj Municipal Assembly

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

DATË/A:	31.08.2026
PËR/ZA/TO:	znj. Adelina Spahiu, Kryesuese e Kuvendit
NGA/OD/FROM:	Kryetari i Komunës z. Sami Lushtaku
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Drejtorit për Buxhet dhe Financa, z. Behxhet Maliqi
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Propozim-Vendimi i Buxhetit Komunal për vitin 2027 dhe Parashikimi i Buxhetit 2028-2029

E nderuara znj. Spahiu

Bashkangjitur me këtë shpresë po ju dërgojmë Propozim-Vendimin e Buxhetit Komunal për vitin 2027 dhe Parashikimin e Buxhetit 2028-2029.

Hartimi i buxhetit komunal përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale të kërkuar nga Qarkoret Buxhetore Komunale 2027/01 dhe 2027/02 të lëshuar nga Ministri i Financave, në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit (LMFPP).

Ky material cakton kufijt final të shpenzimeve sipas kategorive kryesore ekonomike, dhe sipas programeve-nen programeve të bazuara në Statutin e Komunës. Ne synojmë që propozim-buxhetin dhe kërkesën për ndarje buxhetore t'ia dorëzojmë Kuvendit Komunal deri me datën 31 gusht 2026, bazuar në nenin 62.1 të LMFPP-së. Materiali është i bazuar në kërkesat finale për shpenzime të paraqitura nga mbajtësit e buxheteve, dhe si i tillë kërkohej të shqyrtohet në Komitetin për Politikë dhe Financa më së largu më **17 shtator 2026**.


Bashkëngjitur:

- Propozim Vendimin e Buxhetit Komunal 2027 dhe Parashikimi për vitet 2028-2029, dhe
- Listën e Projekteve Kapitale 2027-2029,
- Planifikimi me nen kode për mallra dhe shërbime dhe shërbime komunale

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Kryetari i Komunës në bazë kompetencave të përcaktuara me nenin 58 shkronja h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 15, nenin 50 paragrafi 1 shkronja h) të Statutit Nr.01-110-385 të Komunës së Skenderajt i datës 03.12.2008, dhe nenin 61 parag.1 të Ligjit nr.03/L-048 nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi, plotësuar ndryshuar me ligjin 04/L-116, plotësuar ndryshuar me ligjin 03/L-221, plotësuar ndryshuar me ligjin 03/L-194 plotësuar ndryshuar me ligjin 05/L-063, plotësuar ndryshuar me ligjin 05/L-007, Komitetit për Politik dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Skenderajt në mbledhjen e rregullt të datës _____ Kryetari i Komunës, propozon këtë:

PROPOZIM

PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË KOMUNËS SË SKENDERAJT PËR VITIN 2027 DHE PARASHIKIMET E BUXHETIT 2028-2029

Neni 1

Propozohet miratimi i Vendimit për Buxhetin e Komunës së Skenderajt, për vitin 2027 si dhe parashikimi i buxhetit për vitin 2028-2029 si në vijim :

- Buxheti për vitin 2027 në shumë prej..... **20,814,790.00 € ,**
- Parashikimi për vitin 2028 në shumë prej..... **21,597,459.00 € ,**
- Parashikimi për vitin 2029 në shumë prej..... **22,782,099.00 €**

Neni 2

Të hyrat e Buxhetit të Komunës nga neni një i këtij propozimi planifikohen të realizohen nga dy burime:

- Grandet e Qeverisë,
- Burimi i të hyrave vetanake.

Komuna gjatë viteve në vijim, mund ti realizojë mjetet nga donacionet dhe participimi i qytetarëve. Mjetet nga participimi dhe donacionet nga personat fizik apo juridik do të jenë pjesë e këtij buxheti dhe do ta rrisin buxhetin, varësisht nga viti që do të ndodhë. Rritja e buxhetit do të bëhet vetëm kur të transferohen mjetet në xhirollogarinë e Komunës.

Neni 3

Të hyrat e Komunës planifikohen të realizohen sipas tabelës vijon:

Burimet e Financimit	Buxheti 2027	Vlerësimet 2028	Vlerësimet 2029
Granti i përgjithshëm	9,419,723.00	9,848,334.00	10,620,530.00
Granti për arsim	7,060,106.00	7,271,910.00	7,490,067.00
Granti për shëndetësi	2,344,143.00	2,414,467.00	2,486,901.00
Transferi i Shërbim. Rezide.	200,000.00	200,000.00	200,000.00
Të hyrat vetanake	1,790,818.00	1,862,749.00	1,984,601.00
GJITHSEJ TË HYRAT	20,814,790.00	21,597,460.00	22,782,099.00

Neni 4

Shpenzimet për vitin 2027-2029 sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve dhe sipas viteve si me poshtë vijon:

Viti 2027

BUXHETI TOTAL 2027 NGA DY BURIMET							
Drejtoritë/Programet	Stafi	Paga dhe Shtesa	Mallra dhe Shërbime	Shpenzime Komunale	Subvencione dhe Transfere	Shpenzime Kanitale	Gjithsej
Shpenzimet							
ADMINISTRATA KOMUNALE	283	2,795,116	1,706,175	180,500	890,000	3,018,139	8,589,930
Zyra e Kryetarit	23	262,349	50,000		190,000	280,000	782,349
Prokurimi	6	54,538	19,000				73,538
Administrata dhe Personeli	36	338,603	172,485			30,000	541,088
Çështjet gjinore	3	40,773	15,000				55,773
Inspektimet	10	108,973	125,000				233,973
Zyra e Kuvendit Komunal	27	276,998	20,000				296,998
Buxhet dhe Financa	23	224,601	30,500				255,101
Sherbime Publike	39	386,097	838,100	170,000	120,000	265,000	1,779,197
Zyra komunale për komunitete	8	74,969	18,000				92,969
Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural	12	118,209	19,750		160,000		297,959
Zhvillim ekonomik, inovacion, ndërmarrësi dhe turizem	10	102,084	51,000		140,000	80,000	373,084
Kadastër dhe Gjeodezi	16	146,453	25,930				172,383
Planifikimi Urban dhe Mjedi	12	139,604	175,000			2,363,139	2,677,743
Kulturë, Rini dhe Sport	21	179,811	79,380		150,000		409,191
Administrata e Arsimit	10	89,047	18,000				107,047
Administrata e Shëndetësisë	10	98,241	18,030		130,000		246,271
Shërbimet Sociale	17	153,767	31,000	10,500			195,267
SHËRBIMET E KUJDESIT PRIMAR SHËNDETËSOR	199	2,114,796	671,500	62,400	-	46,000	2,894,696
Sherbimet Rezidenciale	13	100,584	75,000	10,000		15,000	200,584
ARSIM DHE SHKENCË	880	8,016,779	854,000	73,801	120,000	65,000	9,129,580
Arsimi Parashkollor dhe Çerdhet	62	529,124	127,872	7,200		-	664,196
Arsimi Fillor	689	6,318,555	531,168	57,101	120,000	65,000	7,091,824
Arsimi i Mesëm	129	1,169,100	194,960	9,500		-	1,373,560
Totali i shpenzimit të buxhetit	1,375	13,027,275	3,306,675	326,701	1,010,000	3,144,139	20,814,790
	%	62.59	15.89	1.57	4.85	15.11	100.00

Viti 2028

BUXHETI TOTAL 2028 NGA DY BURIMET								
Skenderaj	Drejtoritë/Programet	Stafi	Paga dhe Shtesa	Mallra dhe Shërbime	Shpenzime Komunale	Subvencione dhe Transfere	Shpenzime Kapitale	Gjithsej
Shpenzimet								
ADMINISTRATA KOMUNALE		283	2,830,393	1,706,175	190,000	947,000	3,604,673	9,278,241
	Zyra e Kryetarit	23	262,349.5	50,000		200,000	280,000	792,349.48
	Prokurimi	6	54,537.6	19,000				73,537.64
	Administrata dhe Personeli	36	338,602.7	172,485				511,087.68
	Çështjet gjinore	3	40,773.0	15,000				55,773.00
	Inspektimet	10	108,972.8	125,000				233,972.84
	Zyra e Kuvendit Komunal	27	276,998.2	20,000				296,998.16
	Buxhet dhe Financa	23	224,600.6	30,500				255,100.64
	Sherbime Publike	39	406,096.5	838,100	179,500	120,000	294,000	1,837,696.52
	Zyra komunale për komunitete	8	74,969.3	18,000				92,969.28
	Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural	12	119,209.4	19,750		175,000		313,959.36
	Zhvillim ekonomik, inovacion, ndërmarrësi dhe turizëm	10	102,084.2	51,000		160,000	150,000	463,084.24
	Kadastër dhe Gjeodezi	16	147,452.6	25,930				173,382.56
	Planifikimi Urban dhe Mjedisi	12	139,604.0	175,000			2,880,673	3,195,277.04
	Kulturë, Rini dhe Sport	21	171,045.8	79,380		150,000		400,425.81
	Administrata e Arsimit	10	89,047.2	18,000				107,047.20
	Administrata e Shëndetësisë	10	110,094.8	18,030		142,000		270,124.76
	Shërbimet Sociale	17	163,955.0	31,000	10,500			205,455.02
	SHËRBIMET E KUJDESIT PRIMAR SHËNDETËSOR	199	2,145,155.0	686,500	62,400		50,000	2,944,055.04
	Sherbimet rezidenciale	13	100,584.0	75,000	10,000		15,000	200,584.00
	ARSIM DHE SHKENCË	880	8,016,279.7	854,000	64,300	120,000	120,000	9,174,579.73
	Arsimi parashkollor dhe çerdhet	62	529,124.5	127,872	7,200	-	-	664,196.53
	Arsimi fillor	690	6,318,055.2	531,168	57,100	120,000	120,000	7,146,323.20
	Arsimi i mesëm	125	1,169,100.0	194,960	-	-	-	1,364,060.00
Totali i shpenzimit të buxhetit		1,375	13,092,412.0	3,321,675	326,700	1,067,000	3,789,673	21,597,460
	%		60.62	15.38	1.51	4.94	17.55	100.00

Viti 2029

BUXHETI TOTAL 2029 NGA DY BURIMET								
Skenderaj	Drejtoritë/Programet	Stafi	Paga dhe Shtesa	Mallra dhe Shërbime	Shpenzime Komunale	Subvencione dhe Transfere	Shpenzime Kapitale	Gjithsej
Shpenzimet								
ADMINISTRATA KOMUNALE		283	2,846,873	1,789,225	180,500	1,065,000	4,134,212	10,015,810
	Zyra e Kryetarit	23	262,349	60,000.00		275,000.00	320,000.00	917,349.48
	Prokurimi	6	54,538	19,000.00				73,537.64
	Administrata dhe Personeli	36	338,603	175,000.00				513,602.68
	Çështjet gjinore	3	40,773	15,000.00				55,773.00
	Inspektimet	10	108,973	125,000.00				233,972.84
	Zyra e Kuvendit Komunal	27	276,998	30,000.00				306,998.16
	Buxhet dhe Financa	23	224,601	32,405.00				257,005.64
	Sherbime Publike	39	411,097	856,500.00	170,000.00	120,000.00	195,000.00	1,752,596.52
	Zyra komunale për komunitete	8	74,969	20,000.00				94,969.28
	Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural	12	119,209	30,980.00		180,000.00		330,189.36
	Zhvillim ekonomik, inovacion, ndërmarrësi dhe turizëm	10	102,084	61,000.00		180,000.00	100,000.00	443,084.24
	Kadastër dhe Gjeodezi	16	147,453	32,930.00				180,382.56
	Planifikimi Urban dhe Mjedisi	12	139,604	175,000.00			3,519,212.00	3,833,816.04
	Kulturë, Rini dhe Sport	21	186,272	82,380.00		160,000.00		428,651.99
	Administrata e Arsimit	10	89,047	25,000.00				114,047.20
	Administrata e Shëndetësisë	10	102,311	18,030.00		150,000.00		270,340.76
	Shërbimet Sociale	17	167,992	31,000.00	10,500.00			209,492.20
	SHËRBIMET E KUJDESIT PRIMAR SHËNDETËSOR	199	2,175,556	875,000.00	62,400.00		80,000.00	3,192,956.44
	Sherbimet Rezidenciale	13	122,766	75,000.00	10,000.00		15,000.00	222,766.24
	ARSIM DHE SHKENCË	880	8,012,679	979,088	73,800	120,000	165,000	9,350,566.73
	Arsimi parashkollor dhe çerdhet	62	529,124	132,960	7,200			669,283.53
	Arsimi fillor	689	6,314,455	631,168	57,100	120,000	165,000	7,287,723.20
	Arsimi i mesëm	129	1,169,100	214,960	9,500			1,393,560.00
Totali i shpenzimit të buxhetit		1,375	13,157,874	3,718,313	326,700	1,185,000	4,394,212	22,782,099
	%		57.76	16.32	1.43	5.20	19.29	100.00

Neni 5

Mjetet për Paga dhe Shtesa të përcaktuara dhe të aprovuara më këtë vendim do të shpenzohen për pagimin e stafit të tre (3) Sektorëve kryesor të Komunës. Në sektorët e Komunës më këtë buxhet janë të lejuar të financohen 1375 pozita duke përfshirë edhe anëtarët e Kuvendit Komunal - Qarkorja Buxhetore 2027/02. Është rrit numri i zyrtareve për 7 pozita: Te Arsimit para fillor.

Pagat e aprovuara të stafit më këtë vendim, nuk mund të rriten gjatë vitit fiskal më përjashtim të rritjes së lejuar me vendim të Qeverisë.

Neni 6

Mjetet për Mallra dhe Shërbime si dhe Shërbime Komunale për vitin 2027-2029, janë të planifikuara dhe aprovuara, sipas programeve, nën programeve buxhetore për plotësimin e nevojave gjatë viteve, por gjithë herë duke pas parasysh mundësitë e kursimeve.

Neni 7

Mjetet për Subvencione-Transfero të aprovuar në nenin 4 të këtij vendimi do të shpenzohen për projekte të ndryshme të cilat i kanë propozuar programet buxhetore dhe do të shpenzohen në bazë të kritereve të përcaktuar me Rregullat e përcaktuara nga Departamenti i thesarit – MF-i, si dhe rregulloret e brendshme për subvencione.

Neni 8

Mjetet për Shpenzime Kapitale të aprovuar në nenin 4 të këtij vendimi do të shpenzohen për projekte të aprovuara dhe të paraqitura në sistemin e PIP-it.

Pjesë e këtij vendimi është edhe Lista e projekteve kapitale për tri vite.

Neni 9

Propozim Buxheti për vitin 2027-2029 është bazuar në Qarkoret Buxhetore 2027/01 dhe 2027/02 për Komunitat të lëshuar nga Ministria e Financave.

I dërgohet:

- 1.DBF-së
- 2.Kryesueses së Kuvendit
3. Arkivit të Komunës



Lista e projekteve kapitale 2027-2029


	LISTA E PROJEKTEVE KAPITALE 2027-2029		VITET		
Nr.	EMERTIMI I PROJEKTEVE	Statusi	2027	2028	2029
1	Blerje e gjeneratorit per objektin e komunes	I ri	30,000.00		
2	Bashkëfinancimi	Vazhdim	99,565.93	280,000.00	320,000.00
3	Qillera	Vazhdim	40,000.00		
4	Furzizim me veture zyrtare	I ri	51,000.00		
5	Riparimi dhe zgjerimi i vëndaljeve për autobusë dhe mbulimi i tyre	Vazhdim	85,000.00	84,000.00	10,000.00
6	Blerja e pajisjeve motorike për mirembajtjen e qytetit	Vazhdim	30,000.00	30,000.00	
7	Ndriçimi publik ne Qytet dhe Bashkësit Lokale	I ri	150,000.00	180,000.00	185,000.00
8	Shenjëzimi dhe ndërtimi i shtigjeve të çiklizmit në qytet	I ri		80,000.00	50,000.00
9	Ndërtimi i zonave rekreative në qytet dhe hapësirat e shtigjeve të ecjes ne komune e Skenderajt	I ri	80,000.00	70,000.00	50,000.00
10	Shpronsimi i rrugës 17 Shkurti	I ri	180,434.07		
11	Riparimi dhe rregullimi i parkut "Idriz Rreci" dhe "Shaban Polliuzha"	vazhdim	99,500.00		
12	Riparimi dhe asfalttimi i rrugëve ne qytet	vazhdim	190,500.20	180,000.00	
13	Kanalizimi Aqarevë - Kopiliq i ulët dhe ne BL , Runik, Prekaz , Turiquevc, Qirez, Rezallë, Kline e eperme Polaac dhe qytet	vazhdim	125,405.79	100,000.00	
14	Kanalizimi Syriganë, Banjë - Pemishtë,	I ri	160,000.00	200,000.00	800,000.00
15	Rregullimi i kulmit të objekteve- banesat e kuqe	vazhdim	38,500.00	50,000.00	
16	Punimi i rrjetit të ujësjellësit në BL Qirez	vazhdim	167,217.50	200,000.00	10,000.00
17	Ndertimi i muzeut dhe bibliotekës se qytetit	vazhdim	251,254.85	80,000.00	10,000.00
18	Rregullimi i subqendrës -Likovc	vazhdim	250,000.00		
19	Rregullimi i subqendrës -Runik	vazhdim	100,364.52	100,000.00	
20	Rregullimi i subqendrës -Qirez	vazhdim	150,364.52	150,000.00	
21	Ndërtimi i Objektit të kompleksi i UÇK-së - Objekti Ç-së	I ri	10,000.00	450,000.00	540,000.00
22	Ndërtimi i Objektit te kompleksi i UÇK-së -Objekti K-së	I ri			10,000.00
23	Rregullimi i subqendrës - Klinë e Epërme	vazhdim	200,000.00	140,000.00	10,000.00
24	Tribunat ne stadiumin të qytetit	I ri	54,000.00	100,000.00	10,000.00
25	Asfaltimi i rrugëve lokale në BL ;Likovc,Turiquevc,Runik,Polac,Klin,Prekaz,Qirez	I ri	199,000.00	480,673.00	1,580,000.00
26	Rregullimi i shkollave, palestres dhe fushës se sportit (futbollit) ne Runik dhe Qytet	I ri	50,000.00	100,000.00	250,000.00
27	Asfaltimi i rruges Lagja 3- Prekaz	I ri	20,000.00	140,000.00	90,000.00
